

Raporti për të Drejtat e Njeriut: SHQIPËRIA 2012 (18 Maj 2013)

Përmbledhje e Përgjithshme

Përmbledhje Ekzekutive

Republika e Shqipërisë është një demokraci parlamentare. Kushtetuta ia vesh autoritetin legjislativ parlamentit me një dhomë (Kuvendi), i cili zgjedh si kryeministrin ashtu edhe presidentin. Kryeministri kryeson qeverinë, ndërkohë që presidenti ka pushtet të kufizuar ekzekutiv. Në vitin 2009, vendi zhvilloi zgjedhje parlamentare, të cilat Zyra për Institucionet Demokratike dhe Të Drejtat e Njeriut (ODIHR) e Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë (OSBE) i përshkroi se kishin bërë përparim krahasuar me zgjedhje të mëparshme, por nuk realizuan plotësisht angazhimet e OSBE-së. Forcat e sigurisë raportojnë pranë autoriteteve civile.

Korrupsioni i kudogjendur në të gjitha degët e qeverisjes, e sidomos në sistemin e drejtësisë, mbeti një problem serioz. Axhenda e reformave, në veçanti lufta kundër korrupsionit, faktikisht ngeci teksa partitë politike e zhvendosën vëmendjen e tyre tek zgjedhjet kombëtare të vitit 2013. Institucione shtetërore thellësisht partiake, përfshirë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, minuan të drejtat e qytetarëve për të sfiduar drejtpërdrejt ligjet dhe për të marrë pjesë plotësisht në qeverisjen e tyre. Konsolidimi i vazhdueshëm i pushtetit në duart e partisë në pushtet gërryejti më tej besimin publik në pavarësinë e institucioneve të vendit. Mënjanimi dhe abuzimi i bashkësive romë dhe egjiptiano-ballkanike ishin gjithashtu të rëndësishme të të drejtave të njeriut. Probleme domethënëse ishin edhe rrahja nga policia dhe keqtrajtime të tjera të të dyshuarve gjatë ndalimit dhe marrjes në pyetje, hera-herës për t'u nxjerrë rrëfime.

Probleme të tjera përfshinin dhunën në familje dhe diskriminimin kundër gruas, abuzimin e fëmijëve, si dhe diskriminimin mbi bazë orientimi seksual dhe identiteti gjinor. Vazhduan të raportoheshin raste të trafikimit të personave.

Përpjekjet e qeverisë për të ndjekur penalisht zyrtarët që kryenin abuzime ishin sporadike dhe jokonseguente. Shumë zyrtarë të qeverisë dhe politikanë në përgjithësi, ashtu si dhe gjykatës, gëzonin imunitet nga ndjekja penale, dhe personat me interesa të fuqishme biznesi shpesh ia dilnin të shmangnin ndjekjen penale. Disa zyrtarë të niveleve më të ulëta u ndëshkuan për abuzime. Disa zyrtarë të qeverisë që ishin të implikuar qartësisht në raste abuzimesh u lëvizën dhe iu dhanë poste të tjera në qeverisje pa ndonjë ndëshkim.

Seksioni 1. Respektimi i integritet të personit, përfshirë lirinë nga:

a. Privimi i jetës në mënyrë arbitrare apo të paligjshme

Gjatë këtij viti qeveria bashkëpunoi me hetimin e Task-forcës Speciale Hetimore të Bashkimit Europian (SIFT) në lidhje me akuzat ndaj Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe degëve të saj për pjesëmarrje në ndalimin e shtetasve të etiketuar si “të dënuarit e luftës” nga Kosova, të cilët u mbajtën në kushte çnjerëzore dhe më tej mendohen të jenë vrarë në periudhën nga korriku i vitit 1999 deri në mesin e vitit 2000. Një pjesë e personave të vrarë dyshohet të jenë mbajtur në vende të përkohshme në Bicaj, Burrel, Rripe dhe Fushë-Krujë, dhe raportohet se u janë hequr organet në kohën e vrasjes. Organet e tyre u trafikuan jashtë vendit për përdorim mjekësor jashtë

shtetit. Qeveria shprehu publikisht gatishmërinë e saj për të bashkëpunuar me hetimin e këtyre krimeve dhe dyshimeve për të tjera krime. Në fund të vitit, gjykimi vazhdonte.

Gjatë këtij viti, në lidhje me vrasjet e katër protestuesve në janar 2011 gjatë një proteste përpara ndërtesës së kryeministrit, autoritetet arrestuan ish Komandantin e Gardës së Republikës Ndrea Prendi me akuzë për vrasje; arrestuan shoferin e tij, Margarit Kume, si edhe Armando Kasajn, i cili punonte në zyrën e mbështetjes teknologjike të kryeministrit, me akuzë pengimin e drejtësisë. Në 26 korrik, gjykata i hoqi Kasajt akuzat për pengim. Në fund të vitit, gjykimi vazhdonte.

Gjatë këtij viti, duket të jenë shtuar rastet e vrasjes shoqërore, përfshirë si “gjakmarrjen” ashtu edhe vrasjet për hakmarrje. Këto vrasje shpesh përfshinin banda kriminale. Megjithëse traditat e vjetra në lidhje me gjakmarrjen ndalojnë vrasjen e fëmijëve dhe grave, OJQ-të raportuan disa raste ku vrasësit në mënyrë të qëllimshme kishin në shënjestër të miturit apo gratë. Komiteti Kombëtar i Pajtimit (KKP) deklaroi se numri i grave të vrara në lidhje me krime gjakmarrjeje ishte 10 herë më i lartë sesa në secilin prej 20 viteve të fundit. Avokati i popullit raportoi disa raste në të cilat autoritetet nuk pranuan të mbronin familjet apo të parandalonin vrasjet për gjakmarrje. Komiteti Shqiptar i Helsinkit raportoi se traditat joligjore (kanuni) që diktojnë gjakmarrjen shpesh keqinterpretoheshin në mënyrë të qëllimshme për të justifikuar hakmarrjen apo vrasjet shoqërore.

Në 14 maj Maria Qukaj, një vajzë 17-vjeçare nga Shkodra dhe gjyshi i saj, Kolë Qukaj, u vranë me armë pranë shtëpisë së tyre nga dy vëllezër, në vazhdim të një gjakmarrjeje mes dy familjeve në lidhje me përdorimin e ujit për ujitje. Disa fqinjë dhe aktivistë pohuan se autoritetet kishin dijëni për kërcënimin që vinte prej gjakmarrjes, por nuk pranuan të ndërhynin.

KKP-ja raportoi 152 vrasje për gjakmarrje gjatë vitit. Rastet e gjakmarrjes shqyrtohen nga gjykatat e rretheve. Ligji e dënon vrasjen me paramendim, kur ajo kryhet për hakmarrje apo gjakmarrje, me 20 vjet heqje lirie ose me burgim të përjetshëm.

b. Zhdukja

Nuk pati raportime për zhdukje me motive politike.

c. Tortura dhe trajtime apo ndëshkime të tjera mizore, çnjerëzore ose denigruese

Ndonëse kushtetuta dhe ligji i ndëshkojnë veprime të tilla, policia dhe rojet e burgut ndonjëherë rrahin ose abuzojnë me të dyshuarit dhe të arrestuarit.

Në 20 mars, Komiteti i Këshillit të Europës për Ndalimin e Torturës (KNT) publikoi raportin e vizitës së vitit 2010 në burgjet dhe qendrat e paraburgimit në vend. Megjithëse pjesa më e madhe e personave të intervistuar për raportin pohuan se trajtoheshin në përputhje me rregullat gjatë mbajtjes në arrest, KNT-ja mori një numër të konsiderueshëm raportesh për abuzim fizik, kryesisht gjatë periudhës së marrjes në pyetje; ky abuzim përfshinte forma si goditje me pëllëmbë, gjuajtje me shkelma dhe në veçanti goditje në këmbë me shkop gome. KNT-ja vërejti gjithashtu se të arrestuarit dhe të burgosurit nuk kishin mundësi të mjaftueshme analizash e kontrollesh mjekësore si edhe shërbimesh të tjera.

Avokati i popullit raportoi një rast vdekjeje të të burgosurit, e cila nuk lidhej me shkaqe natyrore. Të burgosurit dyshohet t'i jetë mohuar shërbimi mjekësor, duke qenë i kufizuar në shtrat, dhe ai u gjend i mbuluar në urinë dhe jashtëqitje pasi kishte vdekur në qeli. Avokati i popullit ia paraqiti rastin prokurorisë, por prokurorët nuk hetuan mbi pretendimet e as nuk ngritën akuza në lidhje me vdekjen e këtij të burgosuri.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) raportoi se policia hera-herës tejkalohte përdorimin e forcës dhe trajtimin çnjerëzor. Shumica e ankesave kishin të bënin me ndalime të pajustificuara nga policia, mbajtje nën arrest përtej afateve ligjore, mosnjohje të shtetasve me të drejtat e tyre gjatë arrestimit dhe kushte të papërshtatshme në qendrat e paraburgimit. KSHH-ja tha se policia shpesh raportonte se të ndaluarit, të cilët ankoreshin për abuzim, kishin ardhur me lëndime/plagë të mëparshme.

OJQ-të raportuan se ankesat nga të miturit në paraburgim për abuzime fizike apo dhunë brenda qendrave të paraburgimit dhe burgjeve rrallë trajtoheshin me seriozitet. Në shumë raste, raportohet prej një OJQ-je, janë gjetur roje burgjesh të dehur ndërkohë që kishin në përgjegjësi ruajtjen e të arrestuarve të mitur.

Në 26 nëntor, një video amatore ka regjistruar policë në Tiranë duke arrestuar një djalë 15-vjeçar me akuzë vjedhjen e një flamuri dekorativ. Pasi i dyshuari u prangos, videoja tregon policët duke e gjuajtur me pëllëmbë disa herë në pjesën e pasme të kokës ndërsa e çonin drejt një makine policie. Avokati i popullit tha se kishte marrë ankesa të cilat tregonin se policia vazhdoi të abuzonte fizikisht me të dyshuarin dhe një shokun e tij 14-vjeçar pasi të dy të dyshuarit u morën në rajonin e policisë.

Kushtet në qendrat e paraburgimit dhe në burgje

Kushtet në qendrat e paraburgimit ndryshonin nga një qendër në tjetrën dhe ndërtesat e vjetra ishin larg standardeve ndërkombëtare për kushte higjienike si edhe mungesë të shumë kushteve bazë të jetesës. Keqtrajtimet nga rojet dhe të burgosur të tjerë kërcënonin jetët dhe shëndetin e të burgosurve dhe të ndaluarve.

Kushtet fizike: Në fund të vitit ishin 1793 persona në qendrat e paraburgimit në pritje të gjyqimit dhe 2754 persona të dënuar në burgje, përfshirë 81 femra dhe 97 të mitur. KNT-ja raportoi se ishte praktikë e zakonshme të mbaheshin të paraburgosur të mitur në të njëjtat qeli me të arrestuar të rritur në disa rajone policie. Autoritetet i mbanin gratë dhe burrat në vende të ndara, ku personat në paraburgim në pritje të gjyqimit mbaheshin veç nga të dënuarit. Sipas ligjit, të ndaluarit në paraburgim duhet të transferohen në përgjegjësinë e Ministrisë së Drejtësisë, e cila ka mjedise më të përshtatshme për të burgosur me afat të gjatë, nëse arresti i tyre i kalon 10 orë. Në praktikë, si pasojë e mungesës së komunikimit të mirë mes ministrive, kjo ndodh rrallë dhe zakonisht personat, përfshirë të miturit, mbaheshin në qendrat e paraburgimit të policisë për periudha të gjata.

Kushtet e burgjeve dhe qendrave të paraburgimit ndryshonin mes ambienteve që datojnë nga periudha e komunizmit dhe atyre të hapura pas vitit 1991 si edhe mes mjediseve nën përgjegjësinë e Ministrisë së Drejtësisë dhe atyre nën Ministrinë e Brendshme. Ministria e Drejtësisë mban nën kontroll burgjet dhe qendrat e paraburgimit me afat të gjatë. Kushtet në këto

ambiente ndryshonin gjerësisht. Ndërtesat më të vjetra nuk kishin kushte sanitare të përshtatshme, ajrim, ndriçim, kujdes shëndeti si edhe përdorim uji të pijshëm, ndërsa ato ndërtuar pas vitit 1991 përgjithësisht i përmbushnin standardet ndërkombëtare.

Në 12 maj Avokati i Popullit i kërkoi prokurorisë të niste hetime penale për dyshime për torturë në 18 prill të dy të dënuarve me burg nga pesë roje në burgun Jordan Misja në Tiranë. Tortura e dyshuar ndodhi pasi një i burgosur kërkoi trajtim mjekësor dhe në përgjigje të kësaj kërkese u rrah rëndë nga rojet në infermieri. Kur vëllai i të burgosurit, i cili mbahej gjithashtu si i dënuar në atë burg, protestoi, gardianët pretendohet ta kenë rrahur edhe atë.

Ministria e Brendshme kishte nën kontroll rajone policie dhe mjedise për paraburgim të përkohshëm. Kushtet në këto mjedise ishin tërësisht të papërshtatshme. Në disa raste, ishin pa ngrohje gjatë dimrit, disa nuk kishin kushtet bazë të higjienës si dushe dhe lavamanë, akses të kufizuar në banja, pak ose aspak ajrosje apo dritë natyrale, mungesë krevatesh ose stolash dhe kushte ngushtësie. Raporti i KPT-së për vitin 2010 i quajti kushtet në rajonet e policisë në vend “të tmerrshme.”

Administrimi: Të burgosurit dhe të arrestuarit në paraburgim kanë të drejtë të takojnë të afërmit e këto takime mund të mbahen deri në katër herë në muaj për të rriturit dhe deri në tetë herë në muaj për të miturit. Të burgosurit dhe të ndaluarit në paraburgim kanë liri të ushtrojnë besimin e tyre fetar dhe disa ambiente kanë vende të veçanta për shërbime fetare. Të burgosurit dhe të ndaluarit në paraburgim lejohen t'i drejtojnë ankesa Avokatit të Popullit. Çdo institucion dënimi penal ka një kuti postare në të cilën të burgosurit dhe të ndaluarit në paraburgim kanë të drejtën të hedhin ankesa pa u censuruar. Avokati i popullit raportoi se ky shërbim ishte funksional. Vendi nuk përdorte dënime alternative.

Të burgosurit dhe të ndaluarit në paraburgim kanë të drejtën sipas ligjit të dërgojnë ankesa te autoritetet gjyqësore dhe administrative. Autoritetet kanë hetuar dyshime të besueshme për kushte çnjerëzore dhe kanë dokumentuar rezultatet e hetimeve të tyre, megjithëse rezultatet nuk ishte e lehtë të merreshin nga publiku i gjerë. Drejtoria e Burgjeve iu qëndroi marrëveshjeve për marrëdhëniet e bashkëpunimit me disa OJQ dhe me Avokatin e Popullit. Të burgosurit mund të takoheshin konfidencialisht me Avokatin e Popullit, Komisionin për Mbikëqyrjen e Burgjeve ose me OJQ kombëtare apo ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Megjithatë, OJQ-të raportuan se qeveria rrallë i merrte seriozisht sugjerimet e tyre dhe, kur përballeshin me raporte abuzimi, zyrtarët nuk praninin të hetonin.

Avokati i popullit vërejti se korrupsioni është problem serioz në qendrat e paraburgimit, veçanërisht në programet e lirimit të veçantë. Pati disa raportime në lidhje me të burgosur të cilët merrnin leje për të marrë pjesë në programe të lirimit të veçantë pasi iu kishin dhënë ryshfet zyrtarëve të burgut.

Monitorimi: Qeveria lejoi grupet vendase dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, median dhe Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, si edhe organizmat ndërkombëtare si KPT-ja, të monitoronin kushtet e burgjeve.

Përmirësimet: Gjatë vitit, Drejtoria e Burgjeve nisi regjistrimin e të burgosurve, përfshirë edhe ata me probleme të shëndetit mendor, në programin shtetëror të sigurimeve shëndetësore në

mënyrë që t'iu ofrojë atyre një gamë të plotë shërbimesh mjekësore thelbësore. U rrit prania në media dhe u filmuan e shfaqën në televizion disa dokumentare nga burgjet.

Të burgosur në pesë prej 21 institucioneve patën mundësi të ndiqnin falas arsim ditor në nivelin nëntëvjeçar. Pas përfundimit, të burgosurit u pajisën me dëftesa të cilat nuk e përmendnin faktin që shkolla u krye nën burgim.

d. Arrestimi dhe ndalimi në mënyrë arbitrare

Ligji dhe kushtetuta ndalojnë arrestimin dhe ndalimin në mënyrë arbitrare. Megjithatë, pati raportime se policia arrestoi dhe ndaloi në paraburgim në disa raste në mënyrë arbitrare. Këto raporte ishin më të pakta në numër krahasuar me një vit më parë, kryesisht për shkak të reformave të zbatuara nga Ministria e Drejtësisë.

Roli i Policisë dhe Aparatit të Sigurisë

Drejtoritë e policisë lokale dhe rajonale për ruajtjen e rendit publik janë nga ana vepruese dhe e administrimit nën komandën e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, i cili më pas i raporton Ministrisë së Brendshme. Policia e Shtetit është organizata kryesore përgjegjëse për sigurinë e brendshme. Garda e Republikës mbron zyrtarët e lartë shtetërorë, autoritetet e huaja dhe disa prona shtetërore. Forcat e armatosura nën Ministrinë e Mbrojtjes kanë përgjegjësi kryesisht për mbrojtjen e pavarësisë, sovranitetit dhe integritetit territorial të vendit, me disa detyra shtesë në ndihmë të popullsisë në raste nevojë humanitare. Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH) mbledh informacion dhe kryen aktivitete zbulimi dhe kundërzbulimi të huaj me qëllim mbrojtjen e integritetit të shtetit, pavarësisë dhe rendit kushtetues.

Autoritetet civile ushtruan kontroll efikas mbi policinë e shtetit, Gardën e Republikës, forcat e armatosura dhe SHISH-in, megjithëse në disa periudha burimet shtetërore u përdorën për përfitime personale. Për shembull, pati përhapje të gjerë të rasteve kur policia merrte rryshfete në këmbim të mospublikimit të citimeve ose mos-hedhjes së informacionit personal në bazën e të dhënave kriminale.

Qeveria ka mekanizma për hetimin dhe ndëshkimin e abuzimit dhe korrupsionit. Si pjesë e përpjekjeve për reforma institucionale, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm (SHKB) i qeverisë kreu kontrole, iu përgjigj ankesave dhe ndërmori hetime me vëmendje të veçantë ndaj të drejtave të njeriut, kushteve të burgjeve dhe zbatimit të procedurave standarde të veprimit.

Punonjësit e policisë së shtetit nuk e zbatuan gjithmonë në mënyrë të drejtë ligjin. Njohjet personale, lidhjet politike ose kriminale, infrastruktura jo e mirë dhe mungesa e pajisjeve ose mbikqyrja e papërshtatshme shpesh kanë ndikuar në zbatimin e ligjeve. Pagat e ulëta, drejtimi i dobët dhe motivimi i pamjaftueshëm si edhe mungesa e diversitetit në trupën e policisë kontribuan në vazhdimësinë e korrupsionit dhe sjelljes joprofesionale.

Gjatë vitit, Avokati i Popullit përpunoi ankesa kundër punonjësve të policisë kryesisht mbi probleme gjatë arrestimit dhe ndalimit në paraburgim. Avokati i popullit mori 4252 ankesa gjatë vitit dhe hetoi ose dha këshillime për 385 raste.

Procedurat e arrestimit dhe trajtimit gjatë paraburgimit

Kushtetuta kërkon që të lëshohet mandat nga gjykata për arrestimin e një të dyshuari mbi prova të mjaftueshme. Nuk pati raportime për arrestime në mënyrë sekrete. Prokuroria mund ta lëshojë të dyshuarin ose t'i bëjë kërkesë gjykatës brenda 48 orësh për ta mbajtur më gjatë. Gjykata duhet të vendosë brenda 48 orësh nëse do ta vendosë të dyshuarin në paraburgim, do të kërkojë garanci për lirimin, do të ndalojë udhëtimin apo do t'i kërkojë të akuzuarit të paraqitet rregullisht në polici. Në praktikë prokurorët kanë kërkuar dhe gjykatat rregullisht kanë urdhëruar ndalimin në paraburgim për shumë raste penale. Megjithatë, shpesh gjykatat refuzuan kërkesat e prokurorëve për ndalimin e të akuzuarve me lidhje të forta dhe të njohur. Autoritetet u lejuan të ndaluarve mundësi të menjëhershme për avokat, edhe kundrejt shpenzimeve të shtetit nëse ka qenë e nevojshme.

Kushtetuta kërkon që autoritetet të informojnë personat e ndaluar menjëherë për akuzën e ngritur ndaj tyre dhe për të drejtat që ata kanë. Megjithatë, kjo e drejtë nuk u respektua gjithmonë. Sipas ligjit, policia duhet të informojë menjëherë prokurorinë për arrestimin e bërë. Nuk ka sistem me funksion të mirë për trajtimin e aspektit monetar të lirit me garancisë. Në vend të kësaj, gjykatat shpesh urdhërojnë që i dyshuari të paraqitet në polici ose prokurori çdo javë.

Shumë të dyshuar vendosen në arrest shtëpie, shpesh me kërkesën e tyre pasi kjo kohë u llogaritet si kohë dënimi nëse marrin dënim më pas. Arresti i shtëpisë nuk monitorohet si duhet dhe të dyshuarit lirisht mund të dalin jashtë shtëpisë pa u pikasur nga autoritetet.

Arrestimi në mënyrë arbitrare: Policia në disa raste ndaloi persona për periudha kohore të tepruara për marrje në pyetje pa i arrestuar formalisht.

Ndalimi në pritje gjykimit: Ndonëse ligji kërkon përfundimin e pjesës më të madhe të hetimeve përpara gjykimit brenda tre muajsh, prokurori mund ta zgjasë këtë periudhë deri në dy vite ose më gjatë. Ligji parashikon se mbajtja në paraburgim në pritje të gjykimit nuk duhet të kalojë periudhën prej tre vitesh. Nuk pati raportime për thyerjen e këtij kufiri nga autoritetet gjatë vitit. Zgjatja e ndalimit në pritje të gjykimit shpesh ka ndodhur për shkak të hetimeve të vonuara, gabimeve në mbrojtje apo mosparaqitjes së qëllimshme të palës mbrojtëse. Sipas ligjit, gjykatësi nuk mund të akuzojë avokatin për mosbindje në lidhje me mosparaqitjen në mënyrë që të mund të parandalojë vonesa të tilla nga avokatët.

Kontrollet e SHKB-së treguan se kishte nevojë të shtohet përdorimi i posterave informues në qendrat e paraburgimit për të siguruar që të parandaluarit të ndërgjegjësohen dhe ekspozohen ndaj formularësh të njëtrajtshëm të “njohjes së të drejtave,” të cilat duhet të jenë të pranishme në këto ambiente.

Burimet materiale të kufizuara, mungesa e hapësirës, menaxhimi jo i mirë i kalendarit të gjykatës, personeli i pamjaftueshëm dhe mosparaqitja e avokatëve dhe dëshmitarëve e penguan sistemin e gjykatave të gjykonte në kohë.

e. Mohimi i gjykimit të drejtë publik

Kushtetuta parashikon një gjyqësor të pavarur. Megjithatë, presioni politik, kërcënimi, korrupsioni i përhapur gjithandej dhe burimet e kufizuara penguan hera-herës gjyqësorin të funksiononte në mënyrë të pavarur dhe eficiente. Gjithashtu, seancat dëgjimore në gjykata shpesh ishin të mbyllura për publikun. Punonjësit e sigurisë në gjykata nuk lejonin hyrjen në seanca dëgjimore dhe shpesh kontaktonin gjykatësin kryesor të secilës çështje për të pyetur nëse

mund të lejohej personi që kërkonte të hynte në seancën dëgjimore. Disa agjenci shpesh injoronin urdhrat e gjykatave. Politizimi i emërimeve në Gjykatën e Lartë dhe atë Kushtetuese kërcënuan humbjen e pavarësisë dhe integritetit të këtyre institucioneve. Në 11 qershor, bazuar në një amendament të kushtetutës në vitin 2008, kuvendi zgjodhi presidentin me shumicë të thjeshtë në një proces të cilin shumë vëzhgues e konsideruan partiak dhe në kundërshtim me kushtetutën, e cila kërkon që Presidenti i Republikës të përfaqësojë “unitetin e popullit shqiptar.”

Në 7 dhjetor, kuvendi miratoi kandidaturën e presidentit Nishani për prokurorin e përgjithshëm, duke hequr kështu nga detyra prokuroren e përgjithshme Ina Rama përpara përfundimit të mandatit të saj, të argumentuar prej shumë njohësve ligjorë, si kushtetues. Vëzhguesit vunë re se kjo lëvizje sfidoi në mënyrë të drejtpërdrejtë aftësinë e prokurorit të përgjithshëm për të hetuar e akuzuar zyrtarë të lartë të qeverisë, megjithëse shumë vëzhgues të paanshëm lavdëruan kualifikimet e prokurorit të përgjithshëm të sapoemëruar.

Procedurat e gjykimit

Ligji parashikon prezumimin e të akuzuarve si të pafajshëm derisa të vendoset dënimi. Sistemi gjyqësor nuk parashikon gjykime me juri. Të akuzuarit kanë të drejtën të konsultohen me avokat dhe të kenë avokat të paguar nga shteti nëse nuk e përballojnë dot vetë shpenzimin. Të akuzuarit kanë të drejtën të përballen me dëshmitarët kundër tyre dhe të paraqesin dëshmitarë dhe prova në mbrojtjen e tyre. Të akuzuarit kanë të drejtën e apelimit. Qeveria në përgjithësi i respektoi në praktikë këto të drejta.

Të dënuarit dhe të ndaluarit politikë

Nuk pati raportime për të dënuar ose të ndaluar politikë. Ish të dënuarit politikë nën regjimin komunist vazhduan të bënin kërkesa pranë qeverisë për kompensim. Në 21 shtator një grup i vogël ish të dënuarish politikë nisën një grevë urie në Tiranë nëpërmjet së cilës kërkonin pagesat që u takonin, të pashlyera ende nga qeveria. Gjatë grevës 31-ditore të urisë dy protestues në Tiranë dhe një i tretë në Pogradec i vunë flakën vetes në formë proteste ndaj mospranimit të qeverisë për të negociuar me protestuesit. Policia parandaloi me sukses të paktën një përpjekje tjetër nga një prej protestuesve për t'i vënë flakën vetes dhe vendosi kufizime për lëngjet që lejoheshin brenda zonës së grevës, si përpjekje për të parandaluar vetëdëmtime të tjera. Pas grevës disa protestues raportuan se qeveria u dha një pjesë të pagesave që u takonin ligjërisht. Megjithatë, organizuesit e protestës raportuan se zyrtarë të sigurisë shtetërore monitoronin rregullisht lëvizjet e tyre dhe këta organizues u ankuan se zyrtarë pa uniformë i kishin ngacmuar si ata edhe anëtarë të familjeve të tyre.

Procedurat gjyqësore dhe kompensimet civile

Ndonëse individët dhe organizatat mund të kërkojnë dëmshpërblime civile për dhunim të të drejtave të njeriut, gjykatat ishin të prekshme nga korrupsioni, paaftësia, kanosjet dhe ndërhyrjet politike. Shumë seanca dëgjimore gjyqi u mbajtën në zyrat e gjyqtarëve, gjë që çoi në mungesë profesionalizmi dhe krijoi mundësi për korrupsion. Këta faktorë shkatërruan autoritetin e gjyqësorit, kontribuuan në nxjerrjen e vendimeve të diskutueshme të gjykatave dhe çuan në zbatim të parregullt të kodit civil.

Vendime të gjykatës rajonale të të drejtave të njeriut

Qytetarët mund t'i apelonin vendimet që përfshinin dyshime për dhunim të Konventës Europiane mbi të Drejtat e Njeriut nga shteti, e apelimi mund të bëhej në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut (ECHR). Pati 29 gjykime kundër vendit që nuk ishin ekzekutuar plotësisht. Qeveria dha dëmshpërblim për akuzuesit në 19 raste, ndërsa 10 raste ishin ende në proces pagese. Në përgjithësi palët i morën pagesat në kohë nga qeveria.

Kthimi i pasurisë

Një numër i madh pretendimesh të diskutueshme për prona private dhe fetare të konfiskuara gjatë periudhës së komunizmit mbetën të pazgjidhura. Disa ekspertë deklaruan se, duke parë ritmin e ngadaltë të kthimit të pronave, qeverisë do t'i duheshin 38,6 miliard dollarë dhe 30 vjet për të përfunduar procesin.

Në 31 korrik, ECHR-ja mori vendimin se qeveria duhet të paguajë tre milion euro (4 milion dollarë) për 20 shtetas shqiptarë të cilët kishin çuar çështjet e tyre të kthimit të pasurisë në ECHR. Gjykata vendosi se qeveria kishte dhunuar të drejtat e viktimës për dëmshpërblim të vlefshëm, të drejtën për proces të ndershëm dhe mbrojtje të pronës duke mos i rikthyer pronën viktimës.

f. Ndërhyrje arbitrare në jetën private, familje, shtëpi dhe korrespondencë

Kushtetuta dhe ligji i ndalojnë këto veprime dhe qeveria në përgjithësi i respektoi këto parashikime në praktikë.

Seksioni 2. Respektimi i të drejtave të njeriut, përfshirë:

a. Liria e fjalës dhe e shtypit

Kushtetuta garanton lirinë e fjalës dhe shtypit dhe në përgjithësi qeveria i respektoi këto të drejta në praktikë. Megjithatë, pati raportime se qeveria dhe biznesi ndikuan dhe ushtruan presion në media.

Liria e fjalës: Individët në përgjithësi mund të kritikojnë qeverinë publikisht ose privatisht pa marrë masa ndëshkimore, megjithëse pati disa përjashtime. Pati raportime se disa punonjës të qeverisë u detyruan të merrnin pjesë në tubime të qeverisë, përfshirë raportime se qeveria i transportoi me mjete nëpunësit civilë nga zona jashtë Tiranës për të ndjekur një tubim të Partisë Demokratike për rizgjedhjen.

Liria e shtypit: Mediat e pavarura ishin aktive dhe gjerësisht të pakufizuara, megjithëse pati raste presioni politik e ekonomik të drejtpërdrejtë ose jo, përfshirë kërcënime kundër gazetarëve. Në disa raste presioni politik dhe mungesa e fondeve e ndrydhën shtypin e pavarur dhe gazetarët raportuan se kishin praktikuar vetë-censurim. Partitë politike, sindikatat dhe grupe të tjera botuan gazeta ose revista të pavarura nga ndikimi i qeverisë.

Në raportin vjetor Indeksi i Qëndrueshmërisë së Medias, organizata joqeveritare IREX vërejti se pavarësia e medias në vend pati rënie gjatë këtij viti dhe një numër më i madh grupesh mediatike u bënë pre e ndikimit të drejtpërdrejtë të partive politike.

Qeveria kontrollonte linjën editoriale të Radios dhe Televizionit Publik Shqiptar, i cili kishte në veprim një kanal televiziv kombëtar dhe një stacion kombëtar radioje dhe, me ligj, merrte 50 për qind të buxhetit të tij nga qeveria. Edhe pse stacionet private vepronin në përgjithësi të shkëputur nga ndikimi i qeverisë, shumica e pronarëve besonin se përmbajtja e transmetimeve të tyre mund

të ndikonte veprimet e qeverisë drejt bizneseve të tjera që ata kishin. Pronarët e bizneseve përdorën gjithashtu lirisht grupet mediatike për të siguruar përfitime dhe për të nxitur interesat e tyre me të dyja partitë kryesore politike. Shumë pronarë mediash ‘u bënë qejfin’ drejtuesve të qeverisë për të pasur përfitime dhe për të shmangur taksat.

Dhuna dhe ngacmimi: U shënuan raste dhune kundrejt anëtarëve të medias vizive gjatë vitit dhe gazetarët ishin pre e presionit nga aktorë politikë dhe të fushave të biznesit.

Në 8 qershor truproja e pronarit të një fabrike çimentoje sulmoi gazetarët Dashamir Biçaku, Bledi Gilaj dhe Thimi Samarxhi. Incidenti ndodhi jashtë Komisarariatit të Policisë së Tiranës. Të tre gazetarët paraqitën padi dhe rasti ishte në vazhdim deri në fund të vitit.

Censura dhe kufizimet e përmbajtjes: Gazetarët vazhduan të ankoreshin se botuesit dhe redaktorët e tyre u censuronin punën e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në përgjigje të presioneve politike ose atyre të biznesit. Shumë gazetarë u ankuan se mungesa e kontratave të punësimit shpesh vështirësonte mundësitë e tyre për të raportuar në mënyrë objektive dhe i nxiste të praktikonin vetë-censurë. Ndryshe nga viti 2011, kur pati katër kontrata kolektive punësi për gazetarët, këtë vit nuk pati asnjë kontratë të tillë.

Transmetuesit televizivë dhe botuesit u ankuan se qeveria përdorte blerjet e reklamave për të siguruar raportim favorizues nga grupet mediatike. Reklamuesit privatë kishin të njëjtën prirje nga frika e inspektimeve të taksave.

Ligji për shpifjen/Siguria kombëtare: Në shkurt dhe mars kuvendi amendoi dispozitat e kodit civil dhe penal që ndikonin shpifjen, duke shfuqizuar katër shkelje që garantonin mbrojtje të veçantë për zyrtarë qeveritarë vendas dhe të huaj dhe duke hequr dënimin me burg dhe përfshirjen e padisë publike në raste shpifjeje. Megjithatë, ofendimi dhe publikimi i qëllimshëm i informacionit shpifës u ruajtën si shkelje të ndjekura privatisht si objekt gjobe. Amendimet e kodit civil parashikuan udhëzime për gjyqtarët dhe përfshinë ndryshime të cilat kufizojnë gjobat në nivele proporcionale që nuk rrezikojnë mbijetesën financiare të grupeve mediatike. Disa grupe mediatike vazhduan të prodhonin jaje investigative, të cilat disa herë çuan në lirim dhe ndjekjen penale të disa zyrtarëve publikë të korruptuar.

Në korrik e përditshmja *Shqiptarja.com* deklaroi se zyra e tatim-taksave në Bashkinë e Tiranës e kishte zgjedhur me qëllim për inspektim si reagim ndaj një raporti që kjo e përditshme kishte publikuar, ku hidhte dyshime se familja e kryebashkiakut të Tiranës, Lulzim Basha, ishte e përfshirë në afera korruptive. Pas inspektimit, zyra e tatim-taksave kërkoi kopje të dokumentacionit lidhur me hetimin e *Shqiptarja.com*, gjë e cila sipas së përditshmes ishte e paligjshme. Zyra bashkiake e tatim-taksave u zmbars dhe e përcolli rastin në zyrën kombëtare të taksave.

Në 18 qershor Gjykata e Rrethit Tiranë gjobiti Top Channel me 51 milion lekë (481000 dollarë) për një transmetim të vitit 2009 të kamerave të fshehta, i cili çoi në shkarkimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në atë kohë, Ylli Pango. Gjykata e Apelit e përmbysi këtë vendim. Gjykata e Lartë vendosi që rasti t’i kthehej gjykatës së rrethit. Avokatët e Pangos e apeluan këtë vendim dhe Gjykata e Lartë nuk e kishte dëgjuar akoma rastin deri në fund të vitit.

Kufizimet në botime: Qeveria nuk zbaton kontrolle importi apo masa të tjera për kufizimin e veprimeve të shtëpive botuese.

Ndikimi joqeveritar: Nuk pati grupe opozitare, paraushtarake, kriminale apo terroriste që të kërkonin pengimin e lirisë së shprehjes, përfshirë anëtarët e shtypit.

Liria e rrjetit (Internetit)

Nuk pati kufizime nga qeveria për përdorimin e rrjetit apo raportime që qeveria të ketë monitoruar postën elektronike ose dhomat e bisedave në rrjet pa autoritetin e duhur ligjor. Sipas të dhënave të mbledhura nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit, afërsisht 49 për qind e popullsisë përdorte rrjetin në vitin 2011. Numri i individëve që përdornin rrjetin me valë të gjera në vitin 2011 shkoi në 250000, ndërsa numri i familjeve që përdornin rrjetin fiks në vitin 2011 arriti 174,190, ose 23.5 për qind e numrit të përgjithshëm të familjeve bazuar në numërimin e popullsisë të vitit 2011. Rrjeti fiks ishte më shumë i përqendruar në zona urbane.

Liria akademike dhe ngjarjet kulturore

Nuk pati kufizime nga ana e qeverisë në lirinë akademike apo ngjarjet kulturore.

b. Liria e grumbullimit paqësor dhe formimi i shoqatave

Liria e grumbullimit

Kushtetuta dhe ligji garantojnë lirinë e grumbullimit, dhe në përgjithësi qeveria e respektoi këtë në praktikë.

Disa parti politike raportuan se kryetarë bashkish nga partitë kundërshtarë nuk pranuan të jepnin autorizimin e përshtatshëm për t'i lejuar të mbanin tubime ose demonstrata. Autoritetet deklaruan se kërkesat nuk ishin paraqitur në mënyrën dhe kohën e duhur dhe, për rrjedhojë, nuk mund të përmbusheshin në kohë për grumbullimet e planifikuara. Disa mbështetës të partive të pavarura raportuan gjithashtu se policia i kishte sulmuar ose ndaluar të kryenin fushatë të rregullt ose aktivitete për grumbullimin e mbështetësve.

Në 17 korrik aktivistë të partisë politike Aleanca Kuq e Zi pretenduan se drejtori i policisë bashkiake të Tiranës, Florenc Hoxha, kishte abuzuar në mënyrë verbale dhe fizike ndërsa ata vendosnin postera dhe shpërndanin fletushka. Partia tha gjithashtu se policia kishte ndaluar një aktivist.

Liria për krijimin e shoqatave

Kushtetuta dhe ligji garantojnë lirinë e grupimit në shoqata dhe në përgjithësi qeveria e respektoi këtë liri në praktikë.

c. Liria e fesë

Shikoni *Raportin Ndërkombëtar për Lirinë e Fesë* të Departamentit të Shtetit në faqen e internetit:

www.state.gov/j/drl/irf/rpt.

d. Liria e lëvizjes, personat e zhvendosur në vend, mbrojtja e refugjatëve dhe personat pa shtetësi

Kushtetuta dhe ligji garantojnë lirinë e lëvizjes së brendshme, udhëtimit jashtë shtetit, emigracionin dhe riatdhesimin. Në përgjithësi qeveria i respektoi këto të drejta në praktikë. Qeveria bashkëpunoi me Zyrën e Komisionerit të Lartë të OKB-së për Refugjatët (UNHCR) dhe me organizata të tjera humanitare për sigurimin e mbrojtjes dhe ndihmës për refugjatët, refugjatët e kthyer, azilkërkuesit, personat pa shtetësi dhe persona të tjera që përbënin shqetësim.

Lëvizja brenda vendit: Migruesit brenda vendit duhet të transferojnë pasaportizimin në vendbanimin e ri për të përfituar shërbime publike. Ata duhet të provojnë se janë strehuar në mënyrë të ligjshme nëpërmjet pronësisë së banesës, marrëveshjes së qerasë së banesës apo faturave të shërbimeve të përditshme. Shumë persona nuk kanë mundur t'i japin këto dokumente provuese dhe, për rrjedhojë, kanë humbur mundësinë për të përfituar nga shërbimet e domosdoshme. Të tjerë qytetarë nuk kanë pasur regjistrim formal në vendbanimet e tyre, veçanërisht në bashkësitë rome dhe egjiptiano-ballkanike. Ligji nuk e ndalon regjistrimin e tyre, por shpesh në praktikë ka qenë e vështirë të realizohet.

Mbrojtja e refugjatëve

Mundësia për azil: Ligji garanton dhënien e azilit ose statusit të refugjatit dhe qeveria ka krijuar një sistem për sigurimin e mbrojtjes së refugjatëve. Nuk ka kufi kohor për kërkesat për azil, por ligji parashikon se qeveria duhet të marrë vendimin në lidhje me dhënien e azilit brenda 101 ditësh nga paraqitja e kërkesës. Qeveria në përgjithësi veprroi në përputhje me këtë dispozitë. Qeveria bashkëpunoi në mënyrë aktive me UNHCR-në, e cila dha ndihmë për refugjatët.

Mbrojtja e përkohshme: Qeveria raportoi se nuk pati refugjatë me kërkesë për mbrojtje të përkohshme gjatë vitit 2011. Nuk pati informacion në lidhje me refugjatët gjatë këtij viti.

Seksioni 3. Respektimi i të drejtave politike: e drejta e shtetasve për të ndryshuar qeverinë e tyre

Kushtetuta u garanton shtetasve të drejtën të ndryshojnë qeverinë e tyre në mënyrë paqësore dhe shtetasit e ushtruan këtë të drejtë në praktikë nëpërmjet zgjedhjeve periodike bazuar në të drejtën universale të votës.

Zgjedhjet dhe pjesëmarrja politike

Zgjedhjet e fundit: Në vitin 2009 vendi zhvilloi zgjedhjet parlamentare për të cilat misioni i vëzhgimit të zgjedhjeve nga OSBE/ODHIR u shprehën se përmbushën pjesën më të madhe të angazhimeve të OSBE-së, por megjithatë, “nuk realizuan tërësisht potencialin e vendit për t’iu përmbajtur standardeve më të larta për zgjedhje demokratike.” Misioni i vëzhgimit përmendi në mënyrë të veçantë probleme në procedurat administrative me numërimin e votave, “një mjedis tejet të polarizuar,” mbulim të njëanshëm nga media dhe shkelje procedurale, si për shembull votimi i autorizuar.

Në maj të vitit 2011 pati zgjedhje mbarëkombëtare për kryetarët bashkiakë dhe këshillat bashkiake të karakterizuara nga misioni i vëzhgimit të zgjedhjeve nga OSCE-ja si “konkurruese dhe transparente” por “tejet të polarizuara, të shoqëruara me mosbesim mes partive politike në qeveri dhe opozitë.” Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për të shfuqizuar rezultatet fillestare në garën për kryebashkiak në Tiranë u pa gjerësisht si vendim partiak dhe minoi besimin në pavarësinë dhe paanshmërinë e tij.

Partitë politike: Disa parti politike morën pjesë në qeveri. Gjatë këtij viti disa anëtarë të kuvendit ndryshuan ose braktisën partinë politike së cilës i përkisnin pa e humbur vendin në kuvend. Drejtues të partisë Aleanca Kuq e Zi u ankuan se disa zyrtarë të policisë së Tiranës i sulmuan, në mënyrë të përsëritur, vullnetarët e partisë së tyre ndërsa këta të fundit ishin duke bërë fushatë në gjithë qytetin gjatë muajit qershor. AK-ja pretendoi se zyrtarë të policisë së Tiranës arrestuan, ndaluan dhe sulmuan fizikisht vullnetarin Irfan Gjeçi në 16 korrik, ndërsa ai ishte duke vendosur postera fushate në Tiranë. Zyrtarë të kësaj partie thanë se ky abuzim bëhej me vullnetarët për shkak të lidhjes së tyre partiake. Zyrtarë të AK-së raportuan gjithashtu se zyrtarë nga koalicioni

qeverisë në disa qytete shpesh u mohuan atyre të drejtën për leje që të organizonin demonstrata dhe grumbullime të tjera publike.

Pjesëmarrja e grave dhe pakicave: Ligji urdhëron që gratë të zënë 30 për qind të pozicioneve të emëruara dhe të zgjedhura dhe kodi elektoral parashikon se 30 për qind e kandidatëve duhet të jenë gra. Megjithatë, jo të gjitha partitë e kanë ndjekur kodin zgjedhor dhe gjobat për moszbatim kanë qenë të ulëta. U zgjodhën 23 gra në kuvendin me 140 vende në vitin 2009, një rritje nga nëntë në parlamentin e mëparshëm. Ky numër përfshinte kryetaren e parlamentit si edhe një grua në Këshillin e Ministrave.

Kërkesat për regjistrimin në gjendjen civile dhe mungesa e identifikimit në popullsinë romë bëri që të ishte e vështirë për shumë prej tyre të merrnin pjesë në zgjedhjet e majit të vitit 2011. Disa kandidatë romë u zgjodhën në poste lokale. Vëzhguesit ndërkombëtarë raportuan përpjekje të bëra për të ushtruar ndikim te votuesit analfabetë romë. Nuk pati romë të zgjedhur në kuvend ose në poste ministrash e zëvendësministrash. Disa anëtarë të pakicave greke shërbyen në kuvend dhe në degën ekzekutive në poste ministrash e zëvendësministrash, përfshirë ministrin e punës.

Në 28 qershor, KQZ-ja vendosi se kërkesa e bërë nga Aleanca Kundër Importit të Plehrave (AKIP), një grup aktivistësh dhe organizatorësh ambientalistë, të cilët kërkonin referendum për ligjin e ri të vendit për importin e plehrave, megjithëse e bërë në kohë, ishte me vonesë për shkak të kohës që duhej për të regjistruar të gjitha firmat zyrtarisht. Për më tepër, KQZ-ja kërkoi kopje të kartave kombëtare të identitetit për të gjithë firmosësit. Vendimi i KQZ-së, për rrjedhojë, vonoi rishikimin e gjykatës për ligjshmërinë e referendumit për mbi një vit, duke e bërë kështu të pamundur referendumin gjatë asaj kohe. AKIP-i e apeloj vendimin në Kolegjin Zgjedhor, i cili mori vendimin se vendimet e KQZ-së nuk ishin temë për rishikim juridik. Vëzhguesit vërejtën se vendimet e KQZ-së dhe Kolegjit Zgjedhor bënë që të ishte me të vërtetë e pamundur që persona e organizata private të ndryshonin ligjet nëpërmjet një procesi referendumi.

Seksioni 4. Korrupsioni dhe mungesa e transparencës në qeveri

Ndonëse ligji parashikon ndëshkime penale për korrupsionin zyrtar, qeveria nuk e zbatoi këtë ligj në mënyrë të frytshme dhe shpesh zyrtarët përfshiheshin në praktika korruptive me pandëshkueshmëri. Korrupsioni në degën ekzekutive ishte i përhapur gjerësisht e gjithëpërfshirës. Sistemi arsimor mbeti i korruptuar dhe me raste zyrtarët kërkonin ryshfete nga studentët në mënyrë që këta të fundit të pranoheshin ose të merrnin provimet. Mjekët dhe anëtarë të tjerë të personelit mjekësor shpesh kërkonin pagesa për të dhënë shërbimet që në të vërtetë duhet të jepeshin falas nga qeveria.

Mungesa e përparimit në reformat kyçe institucionale penguan Shërbimin Doganor shqiptar, veçanërisht në fushat e rekrutimit, testimit, marrjes së personelit dhe mbikëqyrjes së përditshme të personelit. Inercia burokratike brenda shërbimit të doganave dhe ndërhyrja politike e lidhur me sigurimin e stafit gjithashtu ngadalësuan përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar për të rishikuar legjislacionin për doganat dhe për të zbatuar ndryshimet që nevojiteshin, duke çuar kështu në perceptimin se procedurat doganore dhe mbledhja e të ardhurave ishin joefikase dhe pre e abuzimit.

Ndonëse qeveria ndoqi penalisht dhe shpesh dënoi disa zyrtarë të nivelit të ulët dhe mesatar për korrupsion, ndjekja penale e zyrtarëve të lartë mbeti problematike dhe shpesh të pandehurit me autoritet të lartë shpesh nxirreshin të pafajshëm, edhe përballë provave të pakapërcyeshme.

Në 16 janar Gjykata e Lartë rrëzoi akuzat për korrupsion ndaj ish zëvendëskryeministrit Ilir Meta me një vendim të diskutueshëm pasi nuk mori e konsideroi provë një videokasetë, e cila supozohej se e shfaqte atë duke diskutuar një ryshfet.

Ligji ndalon ministrat e qeverisë dhe rrethin e tyre të ngushtë familjar që të zotërojnë kompani të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me përgjegjësitë zyrtare të tyre. Që prej krijimit të tij në vitin 2003, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë (ILDKP) ka marrë deklarime për prona nga zyrtarët. Gjatë këtij viti ILDKP-ja dërgoi pesë raste në prokurori për hetime të mëtejshme dhe ndihmoi në zgjidhjen e 43 rasteve të konfliktit të interesit. Në shtator kuvendi miratoi amendime të ligjit, të cilat e rritën me një përlllogaritje prej 300 numrin e përgjithshëm të zyrtarëve publikë të cilëve u kërkohej të deklaroheshin pasuritë. ILDKP-ja gjobiti 43 individë për vonesën e sjelljes së dokumentacionit si dhe për konflikt interesi. Deklarimet e pasurive janë publike, mbi bazën e ligjit organik të ILDKP-së si edhe në ligjin për të drejtën e informimit për dokumente zyrtare. Ligji identifikon qartazi se cilat prona, detyrime, të ardhura vjetore dhe interesa duhet të deklarohen nga zyrtarët publikë. Ky ligj rendit gjithashtu pronat dhe të ardhurat e bashkëshortëve dhe fëmijëve të rritur. Ligji kërkon që zyrtarët të dorëzojnë deklaratat e tyre çdo vit si edhe në kohën kur marrin dhe lënë detyrën publike.

Agjencitë e zbatimit nuk bashkëpunojnë aktivisht dhe në mënyrë të qëndrueshme me shoqërinë civile në shumicën e rasteve. Agjencitë bashkëveprojnë në mënyrë pasive në raste të zgjedhura që u sillen në vëmendje nga aktorë ndërkombëtarë, në shumë raste me kërkesën e shoqërisë civile. Përdorimi i parullave nga ana e qeverisë për nxitjen e “tolerancës zero” në korrupsion shpesh ndrydh raportimin dhe nxit manipulimin e të dhënave që tregojnë se korrupsioni nuk ekziston.

Qeveria ndoqi penalisht zyrtarë të korruptuar dhe shqyrtoi ankesa në lidhje me korrupsionin në polici nëpërmjet avokatit të popullit dhe Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të Policisë së Shtetit Shqiptar. Për pjesën më të madhe të vitit, garantimi i imunitetit gjerësisht për gjyqtarët, deputetët dhe zyrtarë të lartë ndaluan jo vetëm ndjekjen penale por edhe përdorimin e masave hetimore, duke bllokuar kështu mundësinë e qeverisë për të ndjekur penalisht korrupsionin në nivele të larta. Në 18 shtator kuvendi miratoi legjislacionin që u jepte mundësi prokurorëve të nisnin hetime kundër gjyqtarëve, deputetëve dhe zyrtarëve të tjerë të niveleve të larta.

Task-forca e qeverisë kundër krimit të organizuar bashkërendoi aktivitetet kundër korrupsionit. Task-forca përfshin disa ministra dhe drejtues të agjencive të pavarura shtetërore, si për shembull kompania shtetërore e energjisë dhe përfaqësues të organizatave të policisë dhe shërbimit të inteligjencës. Pjesëmarrja në policinë e shtetit përfshin Drejtorinë kundër Krimit Financiar dhe Sektorin Kundër Korrupsionit si edhe Drejtorinë e Analizës së Informacionit Kriminal. Të dyja drejtoritë raportojnë pranë zëvendës drejtorit të përgjithshëm, përgjegjës për Departamentin Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda. Njësitë e përbashkëta hetimore për të luftuar krimin ekonomik dhe korrupsionin (NJPH) janë njësi që përfshijnë disa agjenci të cilat hetuan dhe paditën korrupsionin publik dhe krime të tjera financiare. NJPH-të vazhduan të sillnin raste në disa sektorë me korrupsion të gjerë.

Ministria e Brendshme raportoi se policia e shtetit hetoi 433 raste të lidhura me korrupsionin dhe krimet financiare gjatë vitit dhe arrestoi 82 persona. Gjykata konfiskoi 17,3 milion dollarë në pronë lidhur me këto krime.

Korrupsioni në gjyqësor ishte i përhapur. Shumë gjyqtarë dhanë vendime të cilat nuk dukej të kishin baza në ligje apo në fakte, duke bërë kështu që të besohej se i vetmi shpjegim bindës ishte korrupsioni ose presioni politik. Në 26 korrik Gjykata e Rrethit Tiranë shpalli të pafajshëm një teknik i cili fshiu nga regjistrimi me video dixhitale në kryeministri të gjitha pamjet fotografike të protestës së dhunshme të janarit 2011, gjatë së cilës dyshohet të jenë vrarë katër protestues nga punonjës të Gardës së Republikës.

Në 18 shtator kuvendi amendoi kushtetutën për të kufizuar imunitetin e gjerë që gëzonin disa gjyqtarë dhe ndalonte kështu prokurorët të bënin hetime ose të paraqitnin akuzat për korrupsion derisa të bënin kërkesë publike pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Pak gjyqtarë u ndoqën penalisht për korrupsion sepse pjesa më e madhe e hetimeve penale duhet të mbeten të fshehta, së paku në fillim, për të pasur sukses.

Ligji garanton përdorim nga publiku të informacionit të qeverisë, por procesi për publikimin e këtij informacioni shpesh ishte i paqartë dhe zyrtarët hera-herës nuk ishin të gatshëm të jepnin informacion. Ligji përcakton se e drejta për marrjen e informacionit mund të kufizohet kur informacioni kategorizohet si i klasifikuar ose kur nxjerrja e informacionit do të shkelte mbrojtjen e të dhënave personale. Ligji përcakton një kuadër 40-ditor brenda të cilit institucionet shtetërore përgjegjëse duhet të japin informacionin e kërkuar. Në përgjithësi marrja e informacionit nga qeveria është pa pagesë, por ka raste të veçanta kur paguhet tarifa përpunimi për të mbuluar koston e shërbimit nga ana e institucionit që siguron informacionin. Mospërmbushja dënohet si shkelje administrative e jo si shkelje penale. Të gjithë shtetasit mund të bëjnë kërkesë për të rishikuar mohimin e kërkesës për informacion pranë autoritet ku u paraqit kërkesa fillestare dhe/ose në një nivel më të lartë. Mund të apelojnë gjithashtu në gjykatë.

Në shkurt Instituti Shqiptar i Medias kreu një sondazh për të matur reagimin e qeverisë ndaj kërkesave publike për informacion nga qeveria. Nga 250 kërkesat për informacion të rishikuara në sondazh, 152 morën përgjigje. Nga 98 kërkesat që u refuzuan, 40 ishin dorëzuar nga gazetarë dhe 58 nga shtetas civilë. Ligji kërkon që zyrtarët shtetërorë të lëshojnë gjithë informacionin dhe dokumentet zyrtare me përjashtim të dokumenteve të klasifikuara dhe sekreteve shtetërore. Shtetasit shpesh u përballën me probleme serioze në marrjen e informacioneve të tilla. Shumica e ministrave të qeverisë dhe agjencitë postuan informacioni publik drejtpërdrejt në faqet e tyre të internetit. Megjithatë, bizneset dhe qytetarët u ankuan për mungesë transparence dhe mospublikim të disa rregullave dhe legjislacionit të cilat duhet të jenë informacion themelor për publikun.

Seksioni 5. Qëndrimi i qeverisë në lidhje me hetimin kombëtar dhe ndërkombëtar të dyshimeve për dhunim të të drejtave të njeriut

Një sërë grupesh vendase dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në përgjithësi kanë vepruar pa kufizime nga qeveria, duke hetuar dhe publikuar rezultatet e gjetura prej tyre mbi raste të të drejtave të njeriut. Zyrtarët e qeverisë në përgjithësi bashkëvepruan dhe iu përgjigjën pikëpamjeve të tyre.

Në 11 maj qeveria miratoi një marrëveshje për të bashkëpunuar me Task-forcën Speciale Hetimore të Bashkimit Europian (SIFT) për hetimin e dyshimeve për trafikim organesh dhe krime të tjera ndodhur në vitet 1999 dhe 2000. Hetuesit e SIFT-it udhëtuan në vend gjatë vitit dhe raportuan se qeveria i kishte mbështetur shumë përpjekjet e tyre, duke vërejtur se Kryeministri Berisha dhe disa zyrtarë të tjerë të lartë kishin premtuar bashkëpunim nga ana e tyre në këto hetime.

Organizmat qeveritare të të drejtave të njeriut: Avokati i popullit është institucioni kryesor i të drejtave të njeriut për nxitjen dhe zbatimin e të drejtave të njeriut. Avokati i popullit ka autoritetin të inspektojë mjediset e paraburgimit dhe burgjeve dhe të paraqesë raste për hetim kur viktima nuk ka mundësi ta bëjë vetë. Ndonëse avokati i popullit nuk pati fuqinë të vinte në zbatim vendimet, ai veprroi si monitorues për dhunimet e të drejtave të njeriut. Rastet më të zakonshme përfshinin ankesa nga shtetasit për abuzime të pushtetit nga ana e policisë, moszbatim të vendimeve të gjykatës në rastet civile, shkarkime të padrejta dhe mosmarrëveshje për toka. Avokati i popullit raportoi pranë kuvendit një herë në vit. Kuvendi ka një komision mbi çështjet ligjore, administrimin publik dhe të drejtat e njeriut. Megjithatë ky komision nuk ishte efikas në lidhje me problemet e të drejtave të njeriut dhe nuk iu përgjigj kërkesave për t'u takuar me avokatin e popullit.

Seksioni 6. Diskriminimi, abuzimi nga shoqëria dhe trafikimi i qenieve njerëzore

Ligji ndalon diskriminimin mbi baza gjinie, race, ngjyre, etnie, gjuhe, identiteti gjinor, orientimi seksual, besimesh filozofike, politike apo fetare, ekonomie, arsimit apo gjendjeje shoqërore, shtatzënie, përgjegjësie prindërore, moshe, kushtesh familjare apo martesore, gjendjeje civile, vendbanimi, gjendjeje shëndetësore, prirjeje gjenetike, paaftësie apo përkatësie në ndonjë grup të caktuar. Nuk është paraqitur asnjë rast në gjykatë për të testuar zbatimin e ligjit. Rastet e diskriminimit mund të sillen pranë komisionerit të qeverisë kundër diskriminimit. Megjithatë, zyra e komisionerit të qeverisë ka qenë thujse joefikase dhe shpesh ka dështuar në sfidimin e qeverisë edhe në raste provash të qarta diskriminimi. Ligji lejon komisionerin kundër diskriminimit të dëshmojë si dëshmitar ekspert edhe në apelime të rasteve që ka refuzuar kjo zyrë.

Gratë

Përdhunimi dhe dhuna në familje: Kodi penal ndëshkon përdhunimin, përfshirë edhe përdhunimin nga bashkëshorti. Megjithatë viktimat rrallë e raportojnë abuzimin nga bashkëshorti dhe në praktikë zyrtarët nuk kanë dënuar përdhunimin nga bashkëshorti. Koncepti i përdhunimit nga bashkëshorti nuk ishte përcaktuar mirë dhe autoritetet e publiku shpesh nuk e konsideronin krim. Ligji vendos gjoba për përdhunimin dhe sulmin në varësi të moshës së viktimës. Për përdhunimin e një të rrituri, dënimi me heqje lirie është nga tre deri në 10 vjet, për përdhunimin e një adoleshenti nga mosha 14 deri në 18 vjeç dënimi shkon nga pesë deri në 15 vjet dhe për përdhunimin e një fëmije nën moshën 14 vjeç dënimi është shtatë deri në 15 vjet. Dhuna në familje kundër grave, përfshirë abuzimin nga bashkëshorti, mbeti problem serioz. Gjatë këtij viti policia raportoi raste të dhunës në familje dhe qeveria paraqiti akuza në disa raste. Departamenti i të Drejtave të Barabarta në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta shqyrton çështjet e grave përfshirë dhunën në familje.

Qendra e qeverisë për strehimin e viktimave të dhunës në familje në Tiranë ndihmoi 35 gra dhe 37 fëmijë nga muaji prill i vitit 2011 deri në muajin maj të vitit 2012. Megjithatë qendra e strehimit nuk mund të pranonte viktima pa vendim gjykate. Pas inspektimit të kryer në këtë qendër në prill, avokati i popullit gjeti raste të përsëritura abuzimi nga drejtoresha e qendrës, Dodona Kaloshi, e cila sipas raportimeve ka denigruar viktimat me fjalë dhe ka detyruar disa fëmijë të flenë në dysheme. Policia në mënyrë të rregullt u ka mohuar mbrojtjen grave të strehuara në qendër kur kanë shkuar në gjykatë për t'u paraqitur apo për të çuar fëmijët në shkollë, duke lënë disa të sulmohen nga burrat e tyre gjatë kohës që kanë qenë jashtë qendrës së strehimit. Pas shtimit të kritikave dhe një ekspozije televizive, qeveria e shkarkoi Kaloshin nga ky post disa javë pas rezultateve të gjetura nga avokati i popullit.

Në fund të vitit 2011, OJQ-të administronin 15 streha për mbrojtjen e viktimave nga dhuna në familje, gjashtë në Tiranë dhe nëntë jashtë kryeqytetit. Policia raportoi se kishte marrë 2349 ankesa për dhunë në familje nëpërmjet numrit të tyre të urgjencës. Sipas shifrave të qeverisë, në vitin 2011 pati 2526 raste dhune familjare të raportuara gjatë vitit, krahasuar me 2181 në vitin 2010. Policia nuk e kishte trajnimin apo kapacitetin të shqyrtonte rastet e dhunës në familje.

Ngacmimi seksual: Ligji e ndalon ngacmimin seksual. Megjithatë zyrtarët rrallë e kanë zbatuar këtë ligj. Në shumë komunitete, gratë kanë qenë objekt i diskriminimit shoqëror si rrjedhojë e normave shoqërore tradicionale që i konsideronin gratë të varura nga burrat.

Të drejtat riprodhuese: Çiftet dhe individët kanë të drejtë të vendosin të lirë dhe me përgjegjshmëri numrin e fëmijëve, distancën kohore dhe kohën kur i lindin ata dhe e kanë informacionin dhe mjetet për ta bërë këtë gjë pa u diskriminuar, detyruar apo dhunuar. Qytetarët kanë mundësi përdorimi kontraceptivësh. Sipas ligjit kujdesi shëndetësor iu ofrohet të gjithë shtetasve. Megjithatë, cilësia dhe mundësia për ta pasur këtë shërbim përfshirë edhe kujdesin obstetrik dhe atë të pas lindjes, nuk ishin të kënaqshme, veçanërisht në zonat e thella rurale.

Diskriminimi: Ligji siguron të drejta të barabarta për burrat dhe gratë nën ligjin e familjes dhe ligjin e pronës si edhe në sistemin gjyqësor. Gratë nuk u përjashtuan nga ndonjë profesion as me ligj e as në praktikë, por ishin më pak të përfaqësuara, me numra më të pakët në nivelet më të larta të fushave të tyre. Megjithëse ligji urdhëron pagesë të barabartë për punë të njëjtë, qeveria dhe nëpunësit nuk e zbatuan plotësisht këtë dispozitë.

Përzgjedhja seksuale me bazë gjinore: World Vision dhe Fondi i Popullsisë (UN Population Fund) në OKB nxorën një raport në 19 dhjetor që tregonte se raporti meshkuj-femra në lindje nga viti 2000-10 ishte pothuajse 112 djem të lindur për çdo 100 vajza. Të dhënat treguan se raporti ishte më i lartë në zonat urbane dhe mes klasave më të pasura dhe më të arsimuara, socio-ekonomike. Kur merreshin parasysh familjet pa djem, raporti në Tiranë shkonte deri në 119, duke treguar kështu numrin e lartë të aborteve për përzgjedhjen e seksit të fëmijës.

Fëmijët

Regjistrimi i lindjes: Nënshtetësia garantohet nga lindja brenda territorit të vendit ose nga njëri prej prindërve. Në përgjithësi prindërit inkurajohen të regjistrojnë fëmijën e tyre në kohë. Jepet një shpërblim monetar për regjistrimet e bëra brenda 60 ditëve të para pas lindjes për të nxitur më tej regjistrimin e hershëm. Nuk pati raportime për diskriminim në regjistrimin e lindjes. Megjithatë, në praktikë kërkesat për t'u regjistruar në vendbanim bënë që të ishte e vështirë për prindërit romë dhe egjiptiano-ballkanas të regjistronin fëmijët e tyre dhe të mund të merrnin kështu disa shërbime të tjera shtetërore që vareshin nga regjistrimi. Sipas Qendrës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA), fëmijët e lindur nga migruerit e brendshëm apo

ata që ktheheshin nga jashtë shtetit shpesh nuk kishin certifikata lindjeje ose dokumente të tjera ligjore dhe si rrjedhojë nuk mundeshin të ndiqnin shkollën. Ky problem ishte veçanërisht mes familjeve rome, të cilët shpesh martoheshin në moshë shumë të re dhe nuk i regjistronin lindjet e fëmijëve të tyre.

Arsimi: Ligji garanton nëntë vite arsim falas dhe autorizon shkollat private. Frekuentimi i shkollës është i detyruar deri në klasën e nëntë ose deri në moshën 16, cilado vjen më parë. Në praktikë shumë fëmijë e kanë lënë shkollën më herët sesa lejon ligji për të punuar për familjet e tyre, veçanërisht në zonat rurale. Prindërit duhet të blejnë furnizime, libra, uniforma dhe ngrohëse për disa klasa, shpenzime të cilat kanë qenë tejet të larta për shumë familje, veçanërisht rome dhe pakica të tjera. Shumë familje janë shprehur gjithashtu se këto kosto përbëjnë një prej arsyeve përse nuk i dërgojnë vajzat në shkollë. Megjithëse qeveria ka një program për të siguruar tekste falas për familje me të ardhura të ulëta, shumë familje dhe OJQ raportuan se kjo kategori familjesh e ka pasur të pamundur të marrë tekste shkollore falas.

Abuzimi me fëmijët: Abuzimi me fëmijët, përfshirë abuzimin seksual ka ndodhur edhe pse viktimat rrallë e raportojnë.

Martesa e fëmijëve: Moshë minimale për martesë është 18 vjeç. Ka pasur martesa nën këtë moshë kryesisht në zonat rurale. Sipas statistikave të UNICEF-it, 10 për qind e grave janë të martuara ose të lidhura përpara se të mbushin moshën 18 vjeç. Disa OJQ kanë raportuar se martesat e fëmijëve ndodhnin në komunitetet rurale si pjesë e skemave të trafikimit njerëzor, kur prindërit binin dakord që vajza e tyre nën moshë të martohej me burra të huaj më të mëdhenj në moshë të cilët më pas i trafikonin në vende të tjera.

Shfrytëzimi seksual i të miturve: Në disa raste fëmijët nën moshën 18 u shfrytëzuan për prostitucion. Ndëshkimet për shfrytëzimin seksual të fëmijëve për arsye përfitimi variojnë nga gjoba deri në 15 vjet heqje lirie. Vendi ka një ligj për përdhunimin dhe moshë minimale e marrëdhënieve seksuale me pëlqim është 14 vjeç. Ndëshkimi për përdhunimin e fëmijës nën 14 vjeç është dënim me burg nga pesë deri në 15 vjet. Ligji e ndalon bërjen dhe shpërndarjen e pornografisë me fëmijë dhe ndëshkimet janë me gjobë prej një deri në pesë milionë lekë (9430 deri në 47000 dollarë) dhe dënim me heqje lirie nga një deri në pesë vjet. Ligji nuk e ndalon zotërimin e pornografisë me fëmijë. OJQ-të u ankuan se ato kanë propozuar projektligje për të konsideruar vepër penale zotërimin e pornografisë së fëmijëve por kuvendi nuk e pranoi këtë. Ligjet që kanë të bëjnë me përdhunimin dhe shfrytëzimin seksual të të miturve përgjithësisht u vunë në zbatim në mënyrë të frytshme. Megjithatë, OJQ-të raportuan se ligjet në lidhje me pornografinë e fëmijëve rrallë u zbatuan.

Fëmijët e zhvendosur: Mbetën problem fëmijët e zhvendosur dhe fëmijët e rrugës, veçanërisht brenda komunitetit rom. Fëmijët e rrugës lypnin ose bënin punë të vogla. Disa emigruan në vendet fqinje, veçanërisht gjatë verës. Këta fëmijë janë më të rrezikuarit nga trafikimi dhe disa prej tyre ranë viktimë e trafikimit. Disa fëmijë të zhvendosur u përdorën nga bandat kriminale për të plaçkitur shtëpi sepse ligji ndalon ndjekjen penale për plaçkitje të fëmijëve nën moshën 14 vjeç. U ndoqën penalisht shumë pak raste të trafikimit të fëmijëve.

Fëmijët në institucione përkujdesjeje: Pati raportime se jetimët që u larguan nga kujdestaria e shtetit në moshë madhore u përballën me sfida për gjetje banesash të përshtatshme dhe për përfitim shërbimesh.

Rrëmbimet ndërkombëtare të fëmijëve: Vendi është palë e Konventës së vitit 1980 të Hagës për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve. Për më shumë informacion, shikoni Raportin e Departamentit të Shtetit mbi veprimin në përputhshmëri me të në adresën: www.travel.state.gov/abduction/resources/congressreport/congressreport_4308.html.

Antisemitizmi

U raportua se ishin shumë pak çifutë që jetonin në vend. Nuk pati raportime veprash antisemitizmi.

Trafikimi i qenieve njerëzore

Shikoni *Raportin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore* të Departamentit të Shtetit në adresën: www.state.gov/j/tip.

Personat me aftësi të kufizuara

Kushtetuta dhe ligjet ndalojnë diskriminimin kundër personave me aftësi të kufizuara fizike, ndjesore, intelektuale dhe mendore në punësim, arsim, përfitim kujdesi shëndetësor dhe në dhënien e shërbimeve të tjera shtetërore. Megjithatë, punëdhënësit, shkollat, ofruesit e shërbimit shëndetësor dhe ofruesit e shërbimeve të tjera shtetërore hera-herës kanë shfaqur diskriminime kundër këtyre personave. Ligji urdhëron ndërtesat e reja të ofrojnë mundësi për personat me aftësi të kufizuara por qeveria e ka zbatuar këtë ligj vetëm me raste të veçuara. Sipas numërimit të popullsisë të vitit 2011, 24 për qind e personave me aftësi të kufizuara nuk kishin ndjekur asnjëherë shkollën. Gjashtëdhjetë e pesë për qind e personave me aftësi të kufizuara që nuk kishin shkuar asnjëherë në shkollë ishin femra. Varfëria e përhapur gjerësisht, kushtet e punës të paparashikuara me ligj dhe kujdesi shëndetësor jo i mirë përbënin problem të madh për shumë persona me aftësi të kufizuara.

Personat me aftësi të kufizuara nuk u kufizuan në pjesëmarrjen në aktivitete qytetare, megjithëse në praktikë kufizimet në burime dhe mungesa e infrastrukturës e bënë të vështirë që këta persona të merrnin pjesë në shumë aktivitete. Qeveria ka ndërtuar agjenci shërbimesh sociale për të mbrojtur të drejtat e personave me aftësi të kufizuara por agjencitë shpesh nuk kishin fonde për zbatimin e programeve të tyre. Ligji nuk e kufizon të drejtën e personave me aftësi të kufizuara të votojnë. Megjithatë qendrat e votimit shpesh vendosen në ndërtesa pa kushte të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara duke ndikuar kështu në të drejtën e votës.

Në 15 mars kuvendi miratoi një ligj që pakësoi në mënyrë të konsiderueshme përfitimet për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë ndihmën për transport dhe energji elektrike. Qeveria pretendonte se ligji i ri do të ndihmonte në pakësimin e pretendimeve mashtruese, por organizatat që punonin me personat me aftësi të kufizuara u ankuan se ky ligj do të hiqte ndihmën për personat që nuk shikojnë dhe personat me probleme fizike serioze. Avokati i popullit e kishte nxitur qeverinë të mos e miratonte këtë ligj.

Avokati i popullit inspekton rregullisht institucionet e shëndetit mendor. Pranimi dhe nxjerrja e pacientëve nga institucionet e shëndetit mendor ishte problem për shkak të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të bërë vlerësime psikiatrike të përshtatshme.

Pakicat kombëtare/racore/etnike

Pati raportime se ka pasur diskriminim të konsiderueshëm nga shoqëria kundër anëtarëve të komuniteteve romë dhe egjiptiano-ballkanase. Romët dhe egjiptiano-ballkanasit u përballën me diskriminim në kërkimin e banesave, punësimin, shërbimit shëndetësor dhe arsimin. Disa shkolla nuk pranuan nxënës romë dhe egjiptiano-ballkanas, veçanërisht nëse këta ishin të varfër. OJQ-të lokale raportuan se shumë shkolla që pranuan nxënës romë i linin ata mënjanë në klasa, ndonjëherë edhe duke i ulur veç nga nxënësit e tjerë.

Në 24 janar qeveria nxori tetë familje romë nga një pronë private që ato kishin zënë në Tiranë. Pavarësisht premtimeve të bëra nga qyteti se bashkia do të ofronte për këto familje akomodimin alternativ të përshtatshëm, kjo gjë nuk ndodhi. Avokati i popullit reagoi duke i ftuar familjet të ngrinin kamp në ambientet e zyrës së tij derisa qeveria të gjente një zgjidhje të arsyeshme. Pas disa javësh qeveria u përpoq t'i zhvendoste familjet në disa baraka të braktisura të ushtrisë në rrethinat e Tiranës, ku mungonin kushtet thelbësore përfshirë energjinë elektrike, ujën dhe sistemin e ujërave të zeza. Familjet e komunitetit rreth kësaj zone ishin në kundërshtim me këtë transferim dhe provuan edhe fizikisht të ndalonin romët të hynin në këto baraka. Policia nuk u dha mbrojtjen e duhur familjeve dhe ato e braktisën këtë pronë pas disa incidentesh ngacmimi. Autoritetet nuk dhanë mundësi të tjera strehimi për këto familje.

Ligji garanton status zyrtar pakice për grupet kombëtare dhe veçmas për grupe etnike-gjuhësore. Qeveria i përkufizon grekët, maqedonasit dhe malazezët si grupe kombëtare, mes të cilëve grekët përbëjnë grupin më të madh. Ligji i përkufizon arumunët (vllehët) dhe romët si pakica etnike-gjuhësore.

Pakica etnike greke u ankua për mungesën e dëshirës nga ana e qeverisë për t'u njohur të drejtën qyteteve etnike greke jashtë “zonave të pakicës”, të përkufizuara në periudhën komuniste, të përdornin gjuhën greke në dokumente zyrtare dhe në shenja publike në zonat etnike greke, ose të përfshinin një numër më të lartë grekësh etnikë në administratën publike.

Dalja e grupeve nacionalistë të forta, si AK-ja, rriti tensionet etnike, veçanërisht me pakicat kombëtare maqedonase dhe greke. Në 16 nëntor një grup të rinjsh, të cilët mbanin të veshura bluza me stemën AK, hynë në qytetin e Liqenasit duke kënduar slogane pro-etnike shqiptare. U raportua se grupi hyri në ndërtesat e bashkisë dhe në një shkollë të mesme etnike maqedonase, duke kërcënuar vendasit. Grupi vendosi ngjitëse mbi emërtimet në maqedonisht në shenjat rrugore dhe vendosi foto të aktivitetëve të tyre në rrjetin social Facebook.

Abuzimet shoqërore, diskriminimi dhe aktet e dhunës bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor

Ligji ndalon diskriminimin kundër individëve lezbikë, gej, biseksualë dhe transgjitor (LGBT). Megjithatë nuk janë paraqitur pretendime zyrtare për diskriminim dhe qeveria nuk ka pasur mundësit të zbatojë ligjin.

Pavarësisht ligjit dhe mbështetjes formale të qeverisë për të drejtat e grupit LGBT, ka pasur qëndrime homofobike. Në 23 mars media raportoi gabimisht se aktivistë të grupit LGBT po planifikonin të bënin një paradë krenarie në maj. Zëvendësministri i mbrojtjes, Ekrem Spahiu, iu përgjigj këtij njoftimi duke thënë “Komenti im i vetëm për këtë paradë gej është që organizatorët do i kapim në hu.” Komuniteti ndërkombëtar, shoqëria civile dhe shumë qytetarë e kritikuan këtë koment. Megjithatë, demonstruesit publikë, disa drejtues politikë dhe organizatat fetare e mbështetën komentin e Spahiut. Në një program televiziv disa ditë më vonë një tjetër anëtar i partisë politike të Spahiut i tha hapur aktivistit gej Kristi Pinderi “Nëse do të ishe djali im, do të kisha vënë plumbin në kokë.” Qeveria përsëriti mbështetjen e saj për komunitetin LGBT dhe Kryeministri Berisha deklaroi se aktivistët e grupit LGBT do të lejoheshin të organizonin demonstrata publike sipas të drejtave të tyre të ligjshme. Policia e shtetit bashkëpunoi me

organizatat LGBT dhe dhanë sigurinë e duhur për disa aktivitete në lidhje me grupin LGBT gjatë vitit.

OJQ-të ProLGBT dhe Aleanca organizuan një paradë pedalimi me biçikleta në Tiranë në 16 maj. Gjatë pedalimit një grup të rinjsh hodhën një bombë tymuese dhe shashka plasëse drejt grupit gej. Policia i kapi të dyshuarit, por nuk u vendosën akuza kundër tyre dhe, për rrjedhojë, këta të rinj u liruan pak pas incidentit.

Forma të tjera dhune dhe diskriminimi shoqëror

Ligji ndalon diskriminimin kundër personave me HIV/SIDA. Persona me HIV/SIDA shihen me përbuzje nga publiku, megjithëse nuk ka pasur raportime për dhunë kundër personave të tillë gjatë këtij viti.

Seksioni 7. Të drejtat e punëtorëve

a. Liria për grumbullim dhe e drejta për të negociuar kolektivisht

Ligji dhe rregulloret që lidhen me të si edhe statutet mbrojnë të drejtën e punëtorëve të formojnë sindikata të pavarura, të bëjnë greva të ligjshme dhe të negociojnë kolektivisht. Këto të drejta janë ushtruar në praktikë. Ligji ndalon anëtarët e ushtrisë dhe zyrtarë të lartë të qeverisë të bëhen pjesë e sindikatave dhe kërkon që sindikatat të kenë së paku 20 anëtarë për t'u regjistruar. Ligji garanton të drejtën për të bërë grevë për të gjithë punëtorët me përjashtim ushtarakët me uniformë, policinë dhe personelin e domosdoshëm mjekësor dhe spitalor, personat që bëjnë kontrollin e trafikut ajror dhe shërbimet në burgje si edhe punonjësit kryesorë e dytësorë të ujësjellësit dhe kompanisë energjetike. Punonjësit që nuk përjashtohen për shkak të punës së tyre e kanë ushtruar këtë të drejtë në praktikë.

Ligji ndalon diskriminimin kundër sindikatave dhe garanton rikthimin e punonjësve të pushuar për shkak të veprimtarisë në sindikatë. Në praktikë këto ligje rrallë kanë mbrojtur punëtorët vendas apo emigrantë.

Punonjësit civilë në të gjitha fushat kanë të drejtë kushtetuese të organizohen dhe negociojnë kolektivisht dhe ligji përcakton procedura për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve nëpërmjet marrëveshjeve të negociimit kolektiv. Sindikatat që përfaqësojnë punonjësit në sektorin publik kanë negociuar drejtpërdrejt me qeverinë. Negocimi i frytshëm kolektiv mbeti akoma i vështirë për t'u arritur dhe ishte e vështirë të zbatoheshin marrëveshjet e bëra. Sindikatat shpesh lidhen me partitë politike dhe grevat ndonjëherë politizoheshin. Ligji ndalon grevat e përcaktuara nga gjykata si politike.

b. Ndalimi i punës me forcë ose të detyruar

Ligji ndalon të gjitha format e punës me forcë ose të detyruar. Qeveria nuk e ka zbatuar gjithmonë si duhet këtë ligj.

Shikoni gjithashtu *Raportin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore* të Departamentit të Shtetit në faqen e internetit:

www.state.gov/j/tip.

c. Ndalimi i punës së të miturve dhe moshë minimale për punësim

Ligji vendos si moshë minimale për punësim moshën 16 vjeç dhe rregullon sasinë dhe llojin e punës që mund të kryejnë fëmijët nën moshën 18 vjeç. Fëmijët nga moshë 16 deri në 18 vjeç mund të bëjnë vetëm disa punë të përcaktuara. Ndonëse ligji parashikon që Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ka përgjegjësinë të zbatojë kërkesat minimale të moshës nëpërmjet gjykatave, kjo ministri nuk e ka zbatuar si duhet ligjin. Inspektorët e punësimit hetuan sektorin formal të punës ndërkohë që puna nga të miturit në më të shumtën e rasteve kryhet në sektorin informal. Shumica e kontrolleve të punës janë bërë në fabrika këpucësh dhe tekstilësh dhe u gjetën disa raste punësimi të miturish në këto kontrolle.

Ligji e konsideron vepër penale shfrytëzimin e fëmijëve për punë ose shërbime të detyruara, por qeveria nuk e zbatoi si duhet ligjin. Sipas një përlllogaritjeje të CRCA-së në vitin 2010, mbi 50000 fëmijë nën moshën 18 vjeç punon së paku me orar të pjesshëm. CRCA-ja raportoi se shumica e të punësuarve të mitur punonin si shitës në rrugë ose dyqane, si lypës, fermerë dhe barinj, shpërndarës droge, larës automjetesh, punonjës në fabrika tekstilësh, minatorë ose lustrues këpucësh. Disa prej fëmijëve që lypnin në rrugë ishin brez i dytë ose i tretë lypësish brenda familjes. Kërkimet treguan se lypja niste që në moshën katër apo pesë vjeç. Ndonëse kodi penal ndalon shfrytëzimin e fëmijëve për lypje, policia në përgjithësi nuk e ka zbatuar këtë ligj. Qeveria nuk ka ofruar burime për rehabilitimin e fëmijëve që lypnin dhe jetojnë në rrugë.

Shikoni gjithashtu *Të Dhënat mbi Format më të Këqija të Punës së të Miturve* nga Departamenti i Punës në faqen e internetit:

www.dol.gov/ilab/programs/ocft/tda.htm.

d. Kushtet e pranueshme të punës

Paga minimale kombëtare ishte 21000 lekë (198 dollarë) në muaj. Sipas INSTAT-it, paga mesatare për punonjësit e qeverisë në çerekun e dytë të vitit ishte 51270 lekë (484 dollarë) në muaj. Krahasimisht pragu kombëtar i varfërisë në vitin 2011 ishte 6266 lekë (59 dollarë) në muaj. Instituti Shqiptar i Statistikave raportoi se pagat mesatare mujore në sektorin publik ishin rritur me 12,5 për qind nga viti 2011. Kodi i punës kërkon paga të barabartë për punë të njëjtë.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ka për detyrë të zbatojë pagën minimale. Ndonëse ligji përcakton javën 40-orëshe të punës, janë marrëveshjet individuale dhe kolektive ato që e përcaktojnë numrin e orëve të punës në javë. Ligji përcakton pushime vjetore të paguara, por në praktikë vetëm punëdhënësit në tregun formal të punës kanë garantuar të drejtat për pushime të paguara. Shumë persona kanë punuar gjashtë ditë në javë. Ligji kërkon pagesë për punë jashtë orarit ose në ditë pushimi, por punëdhënësit nuk i kanë zbatuar gjithmonë këto dispozita në praktikë. Ligji kufizon orët maksimale të punës në javë deri në 50 dhe parashikon shpërbllim për orët jashtë orarit. Qeveria nuk pati standarde për numrin minimal të periudhave të pushimit në javë dhe rrallë zbatoi ligjet që lidheshin me sasinë më të lartë të orëve të punës, kufijtë për punën jashtë orarit apo shpërbllimet për punë jashtë orarit. Në praktikë këto ligje shpesh nuk zbatoheshin për punonjësit në sektorin informal, si për shembull ndihmësit shtëpiakë dhe emigrantët.

Nuk ka pasur të dhëna të besueshme në lidhje me ekonominë informale por masa që zinte sektori informal vazhdoi të ishte e rëndësishme. Vendi pati GDP zyrtare prej 12 miliardë dollarë, por përlllogaritjet informale e rritën këtë numër në 24 miliardë dollarë kur u përfshinë në përlllogaritjen e GDP-së.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ka përgjegjësinë e zbatimit të standardeve dhe rregullave shëndetësore dhe atyre të sigurisë në lidhje me vendin e punës. Mungonte tërësisht zbatimi i tyre. Kushtet e vendit të punës shpesh ishin shumë të papërshtatshme dhe në disa raste të rrezikshme. Shpesh gjobat nuk pengonin shkeljet pasi agjencitë e zbatimit të ligjit nuk kishin mjetet për zbatimin e grumbullimit dhe, për rrjedhojë, rrallë ngrinin akuza për shkelje. Nuk pati programe qeveritare për të siguruar mbrojtje sociale për punonjësit në ekonominë informale.

Shkeljet e standardeve në paga dhe sigurinë në punë ndodhnin më shpesh në industritë tekstile dhe të prodhimit të këpucëve, në ndërtim dhe miniera.